

VENDIM
Nr. 436, datë 17.5.2017

**PËR PROCEDURËN E PAJTIMIT DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË ZYRAVE
SHTETËRORE TË PAJTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 4 e 5, të nenit 189, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për punën të funksionojë Zyra Kombëtare e Pajtitimit dhe pranë Drejtorisë Rajonale të Punësimit në çdo qark të funksionojë zyra e pajtitimit për pajtimin e konflikteve kolektive.

2. Ministri përgjegjës për punën ose organi administrativ i autorizuar prej tij, në rastin e dështimit të ndërmjetësit, brenda tri ditëve, njofton zyrën e pajtitimit.

3. Nëse palët, gjatë shqyrtimit të konfliktit në zyrën e pajtitimit, pajtohen, hartohet një procesverbal, i cili, pasi nënshkruhet prej tyre, merr fuqinë e kontratës kolektive, e detyrueshme për t’u zbatuar nga këto palë.

4. Në mungesë të një pajtimi të drejtpërdrejtë të palëve, gjatë debateve në seancat e shqyrtimit, zyra e pajtitimit propozon pajtimin e tyre.

5. Nëse njëra nga palët, pa arsye të justifikuara, nuk paraqitet në seancat e shqyrtimit të konfliktit, zyra e pajtitimit, pasi dëgjon palën e pranishme dhe mbledh të dhëna të nevojshme, ka të drejtë të propozojë pajtimin.

6. Nëse ky propozim nuk mund të bëhet pa dëgjuar palën, që nuk është e pranishme, zyra e pajtitimit ka të drejtë të vendosë për thirrjen e palëve në një seancë tjetër, brenda 10 (dhjetë) ditëve.

7. Kryetari i zyrës së pajtitimit pranë Drejtorisë Rajonale të Punësimit në çdo qark ndihmohet nga specialisti përgjegjës për marrëdhëniet e punës dhe kryetari i Zyrës Kombëtare të Pajtitimit ndihmohet nga specialisti përgjegjës për marrëdhëniet e punës në ministrinë përgjegjëse për punën, për analizën dhe administrimin e dosjes së konfliktit.

8. Nëse anëtari i zyrës së pajtitimit ka konflikt interesi në shqyrtimin e konfliktit, anëtari nuk ka të drejtë të marrë pjesë në procedurën e pajtitimit. Kushtet kur anëtari është në konflikt interesi përcaktohen në rregulloren e zyrës së pajtitimit.

9. Anëtarët e zyrës së pajtitimit votojnë për propozimin e pajtitimit, i cili vendoset me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës dhe, në rast barazimi votash, vota e kryetarit është përcaktuese. Zyra e pajtitimit del me një propozim të nënshkruar nga anëtarët dhe kryetari i zyrës së pajtitimit.

10. Kryetari i zyrës së pajtitimit njofton me shkrim palët për propozimin e pajtitimit dhe u kërkon atyre që brenda 4 (katër) ditëve pune të deklarojnë, me shkrim, pranimin ose kundërshtimin e këtij propozimi.

11. Nëse palët e pranojnë dhe e nënshkruajnë propozimin e zyrës së pajtitimit, ky propozim merr fuqinë e kontratës kolektive, e detyrueshme për t’u zbatuar nga palët. Në rast të kundërt, kryetari i zyrës së pajtitimit deklaron me shkrim dështimin e pajtitimit të palëve në konflikt dhe brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e marrjes së përgjigjes njoftohet pala e interesuar.

12. Zyra e pajtitimit pajiset me një regjistrer protokolli dhe me vulën përkatëse.

13. Shpërblimi i anëtarëve të Zyrës Kombëtare të Pajtitimit dhe zyrës së pajtitimit pranë Drejtorisë Rajonale të Punësimit në çdo qark bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi.

14. Shpenzimet për shpërblimin e anëtarëve të zyrave shtetërore të pajtitimit mbulohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

15. Vendimi nr. 741, datë 6.11.2003, i Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e pajtitimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të zyrave shtetërore të pajtitimit”, shfuqizohet.

16. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi